



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 14.02.2025

Nr: 101

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË**  
**DENONCIMIN NR. 6, DATË 11.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,**  
**TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË**  
**KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

**SUBJEKT:** Zj. Elisa Spiropali  
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Z. Engjëll Agaçi  
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

**OBJEKT:** Marrjen e hapave të nevojshëm për parandalimin e miratimit të Projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"

**BAZA LIGJOR:** Neni 91, pikat 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

**KONSTATOJ:**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 11.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 6 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

Data: 14.02.2025

Nr: 101  
Ora: 12:00



"Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 6, datë 11.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK"

*“Më datën 23 dhjetor 2024, në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Ky projektligj është ende duke u diskutuar në komisione dhe pritet të miratohet në seancat e ardhshme plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji ofron përfitime të drejtëpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht të atyre që vuajnë dënimin në sistemin peniteciar në vend”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
  - Zj. Elisa Spiropali Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë;
  - Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**